

NJOFTIM

UDHËZUES MBI RESPEKTIMIN E STANDARTEVE TË BASHKIMIT EUROPIAN NË INVESTIME NË AUTOMJETE BUJQËSORE NË IPARD II, I NDRYSHUAR

Shpenzimet për blerjen e një traktori konsiderohen të pranueshme në IPARD II, duke marrë parasysh kushtet e mëposhtme:

- 1) Në të gjitha programet IPARD II, thuhet se, nga shuma totale e fondeve të alokuara të BE-së, për masën 1 "Investimet në asete fizike të fermave bujqësore", një maksimum prej 20% mund të shpenzohen në traktorë.
- 2) Këto investime, nën masën 1, do të respektojnë legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian në lidhje me mbrojtjen e mjedisit¹, në veçanti në lidhje me kufijtë e emetimeve të gazrave dhe grimcave të ndotësve².

Prandaj, të gjithë traktorët e bashkë financuar të BE-së, përveç atyre të treguar në Aneksin e mëposhtëm, do të pajisen me motorë që përputhen me kufijtë e emetimit të ndotësve të Kategorisë V³.

- 3) Për 'furnizimet' (për shembull traktorë) me një vlerë të kontratës më pak se 100 000 EURO (pa TVSH), nuk ka kufizime në lidhje me vendin e origjinës së furnizimeve. Pra dhe traktorë nga vendet jashtë BE-së janë të pranueshëm. Sidoqoftë, të gjithë duhet të respektojnë legjislacionin e BE-së.

Duke pasur parasysh kërkesat/standardet e Bashkimit Evropian kërkohet nga aplikantët të respektojnë **kërkesat aktuale**, përkatësisht të gjithë traktorët e vendosur në treg⁴ (me përjashtimet e parashikuara në Aneks) duhet të jenë në përputhje me kufijtë e emetimit të ndotësve të Kategorisë V. Këto kritere do të aplikohen për **Thirrjen e tretë të IPARD II dhe në vijë**

ANEKS

¹ Ekziston një seksion specifik për industrinë e automobilave në lidhje me traktorët:
https://ec.europa.eu/growth/sectors/automotive/legislation/tractors_en.

² Rregullorja (BE) Nr. 167/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit më 5 Shkurt 2013 mbi miratimin dhe mbikëqyrjen e tregut të automjeteve bujqësore dhe pyjore dhe rregullorja e deleguar e Komisionit (BE) 2018/985 për Rregulloren plotësuese (BE) Nr 167/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me kërkesat e performancës së mjedisit dhe njësive shtytëse për automjetet bujqësore dhe pyjore dhe motorët e tyre dhe shfuqizimin e Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2015/96.

³ Siç përcaktohet në Aneksin II të Rregullores (BE) 2016/1628 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 14 Shtatorit 2016 mbi kërkesat në lidhje me kufijtë e emetimit të gazrave dhe grimcave dhe aprovimin e tipit për motorët me djegie të brendshme për makineritë e lëvizshme jo-rrugore, duke ndryshuar Rregulloret (BE) Nr. 1024/2012 dhe (BE) Nr. 167/2013 dhe duke ndryshuar dhe shfuqizuar Direktivën 97/68 / KE.

⁴ Hedhja në treg e përcaktuar në Nenin 3 (39) të Rregullores (BE) Nr 167/2013.

Kushti aktual i zbatueshme është se të gjithë traktorët të hedhur në treg duhet të jenë të pajisur me një motor në përputhje me kufijtë e emetimit të ndotësit të Kategorisë V.

Pavarësisht nga kjo kërkesë e përgjithshme, **traktorët me shasi të ngushtë (NTT)**⁵ pajisur me motorë në intervalin e fuqisë midis 56 kW dhe 130 kW dhe në përputhje me kufijtë e emetimit të ndotësit të Kategorisë IIIB⁶ të hedhur në treg **deri më 31/12/2019** në përputhje me, dhe në varësi të kufizimeve të **dispozitave të fleksibilitetit** të përcaktuara në Nenin 13 të Rregullores (BE) 2018/985.

Për më tepër, nga data e mësipërme deri më **deri më 31/12/2021**, këto NTT të pajisura me motorë Kategoria IIIB në intervalin e fuqisë midis 56 kW dhe 130 kW, mund të jenë akoma në treg për aq sa kohë që motorët janë prodhuar deri më 31/12/2019 dhe traktorët prodhohen deri më 30/6/2021. Këto motorë janë të përcaktuar **si motorë tranzitorë**⁷.

Informacion shtesë në përputhje me Rregulloren (BE) 2020/1040⁸:

Përfundimisht, me ndryshimin e dispozitave kalimtare të Rregullores (BE) 2016/1628, për të adresuar ndikimin e krizës COVID-19, të prezantuar nga Rregullorja (BE) 2020/1040, **deri më 31/12/2021**, të gjithë traktorët e tjerë të pajisur me motorë në intervalin e energjisë 56 kW ose mbi 130 kW, mund të vendosen akoma në treg për aq sa motorët janë prodhuar deri më **31/12/2018** dhe traktorët prodhohen deri më **30/06/2021**. Këto motorë janë të përcaktuar **si motorë tranzitorë**.⁷

Informacion shtesë në përputhje me Rregulloren (BE) 2021/1068:

Për shkak të vazhdimit të zingjirit furnizimit dhe ndërprerjeve të shkaktuar nga COVID - 19, vala e dytë dhe tretë, prodhuesit nuk do të jenë të aftë të respektojnë afatet e 2021 të aplikuar për makinerit me motorë tranzitore në intervalin e fuqisë ndërmjet 56 KW dhe 130KW, pa shkaktuar dëme ekonomike.

Për sa më lart, Rregullorja BE 2021/1068 shtyn afatet, për të shmangur riskun që motorët tranzitor të mos mund të vendoseshin në kohe në makineri dhe për rrjedhojë të hidheshin.

Për këto motorë, prodhimi është i mundur deri më 1 janar 2022 dhe vendosja në treg deri më 1 shtator 2022

⁵ Traktorët me shasi të ngushtë janë traktorë që i përkasin kategorive T2, C2 dhe T4.1, siç përcaktohet në nenin 4 të Rregullores (BE) Nr 167/2013.

⁶ Siç përcaktohet në pikën 4.1.2.5. të Aneksit I të Direktivës 97/68 / EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 16 Dhjetorit 1997 mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me masat kundër emetimit të ndotësve të gaztëdhe grimcave nga motorët me djegie të brendshme që do të instalohen në makineritë e lëvizshme jo-rrugore

⁷ Motorët kalimtarë përcaktohen në Nenin 3 (32) të Rregullores (BE) 2016/1628.

⁸ Rregullore (BE) 2020/1040 e Këshillit dhe Parlamentit Evropian e 15 korrikut 2020, për ndryshimin e Rregullores (BE) 2016/1628, lidhur me dispozitat kalimtare për adresimin e impaktit të shkaktuar nga kriza e COVID -19.